

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Orig. Org.Jedinea Org.Unit	SP-02	Nr Prot. Broj Prot. Prot.No	7006-2/19
Nr. Filaqevë Brosjeronica No pages	-05-	Data Datum Date	29.01.20
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	22.01. 2020
REFERENC-Ë:	19/7006/1- 961/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Ujë Rugove" Sh.p.k Obiliq
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 19/7006/1- 961/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për fabrikën për prodhimin (ambalazhimin) e ujit të thartë natyral në lokalitetin Sallabajë, K.K. Podujevë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Kompanisë “Ujë Rugove” Sh.p.k Obiliq, për fabrikën për prodhimin (ambalazhimin) e ujit të thartë natyral në lokalitetin Sallabajë, K.K. Podujevë.


A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të Kompanisë “Ujë Rugove” Sh.p.k Obiliq, për fabrikën për prodhimin (ambalazhimin) e ujit të thartë natyral në lokalitetin Sallabajë, K.k. Podujevë në pjesën e ngastres kadastrale nr. 00490-0, numri i njesise kadastrale 08-942-03/47373 , Zona kadastrale Sallabajë, K.k. Podujevë.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM , neni 20 , është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep **Pëlqim Mjedisor**, për fabrikën për prodhimin (ambalazhimin) e ujit të thartë natyral në lokalitetin Sallabajë, K.k. Podujevë , nën kushtet si vijon:

- Të ndërtohet sistemi për trajtimin e ujërave të përdorura ne fabrikën për prodhimin (ambalazhimin) e ujit të thartë natyral në lokalitetin Sallabajë, K.k. Podujevë , nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza

Faqe 2 nga 5



(seperator për vajra dhe i yndyrave, dekantori dhe grupa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor.

- Të gjitha kanalet e kullimit brenda dhe jashtë hallës prodhuese duhet të jenë të mbuluara për të siguruar rrjedhjen normale të tretësirave të lëngëta të ndotura, për në dekantor dhe seperator.
- Të mos lëshohen ujërat e ndotura (tretësirat) në mjedis pa u trajtuar në dekantor, dhe seperator (neutralizator).
- Të sigurohen kontejner të posaçëm për deponimin e mbeturinave të ngurta , në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër.
- Të vendoset sistemi i monitorimit të vazhdueshëm të emisioneve për ujera që shkarkohen në mjedis, rezultatet të raportohen në MMPH .
- Të mirren masat rehabilituese pas perfundimit të projektit
- Aplikuesi duhet t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.
- Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (merret).



Pëlqimi Mjedisor është kusht për marrjen e Lejes Ndërtimore.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 te Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike:Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/7006/1 - ZSP/ 34/20 datë: 22.01.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm

Faqe 4 nga 5

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

